



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE
DHE ÇESHTJEVE FISKALE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT FISKAL

Nr. 13709/2 Prot.

Tiranë, më 9 / 11 / 2017

Lënda: Dërgohet për njohje dhe zbatim

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Laprakë, Tiranë

Znj. Ikonomi,

Bashkëlidhur, gjeni për njohje dhe zbatim Urdhrin nr. 123, datë 9.11.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 90, datë 18.11.2014 "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar,"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 13709 / Prot

Tiranë, më 8 / 11 / 2017

URDHËR

Nr. 123 , datë 8 . 11 . 2017

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHURIN NR. 90, DATË 18.11.2014
“PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS NË SHËRBIMIN DOGANOR
SHQIPTAR,”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 16, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”, pikës 2, të nenit 29, të Ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131 “Për rregullat e etikës në administratën publike”,

U R D H Ë R O J:

Në “Kodin e Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar”, miratuar me Urdhër nr. 90, dt. 18.11.2014, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në bazën ligjore të Urdhrit, para dhe pas togfjalëshit “pikës 2, të nenit 29, të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, shtohen togfjalëshat me përmbajtjen e mëposhtme”:

“Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 16, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar” ..., “të ligjit nr. 9131 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.”

2. Në nënpikën 10.3, të pikës 10, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Gjatë kohës së qëndrimit në zyrë dhe ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në Degët Doganore, të gjithë nëpunësit dhe punonjësit duhet të mbajnë mbi veshjen e sipërme kartën e identifikimit të punonjësit të Doganës.”

3. Në pikën 12, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nënpikës 12.1, shtohen nënpikat 12.1.1 dhe 12.1.2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“ 12.1.1 Në takime pune, mbledhje me titullarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në raportimin tek eprorët, aparati i telefonit celular duhet të jetë i fikur ose pa tingull.

12.1.2 Gjatë komunikimit, çdo nëpunës dhe punonjës, duhet të karakterizohet nga etika dhe respekti i ndërsjellë. Komunikimi verbal në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në Degët Doganore, nuk duhet të bëhet me zë të lartë.”

b) Në nënpikën 12.5, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në të gjitha ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në Degët Doganore (përfshirë këtu kafe-barin brenda godinës së institucionit), gjatë orarit të punë, ndalohet rreptësisht përdorimi i pijeve alkoolike.”

c) Në nënpikën 12.6, shtohet paragrafi si vijon:

“Në të gjitha ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në Degët Doganore ndalohet rreptësisht pirja e duhanit (përfshirë këtu kafe-barin brenda godinës së institucionit). Pirja e duhanit lejohet vetëm në ambientet e jashtme.”

ç) Nënpika 12.7 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“12.7. Rregullat e Veshjes dhe paraqitjes së jashtme

Veshja dhe paraqitja e nëpunësve dhe punonjësve duhet të jetë serioze, për ta përfaqësuar sa me denjësisht administratën doganore.

Paraqitja e nëpunësve dhe punonjësve mund të influencojë mbi idenë që publiku krijon për doganën, si dhe për mënyrën se si ajo plotëson detyrat e saj. Veshja duhet të jetë në raport me funksionet që kryen dhe duhet të respektohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në këtë fushë:

a) Për nëpunësit meshkuj në pozicionin Kryetar Dogane apo Drejtor Drejtorie dhe funksione të tjera të barazvlefshme apo më të larta në hierarki se Drejtor Drejtorie, veshja duhet të jetë me xhaketë apo kostum, këmishë e kravatë. Gjatë periudhës së pranverës dhe verës, veshja mund të jetë me pantallona serioze, këmishë dhe kravatë.

Ndërsa për nëpunësit (apo punonjës të së njëjtës kategori me nëpunësit) e tjerë meshkuj, paraqitja duhet të jetë me pantallona serioze e këmishë.

b) Veshja për nëpunëset femra, apo punonjëset e së njëjtës kategori me nëpunëset, duhet të jetë me funde e fustane me gjatësi të pranueshme, pantallona serioze, këmisha e bluza me mëngë dhe pa dekolte.

c) Veshjet e rastit (xhinse, etj) lejohen vetëm ditëve të premtë.

ç) Të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në Degët Doganore, të të gjitha kategorive, duhet të kujdesen për higjienën

personale dhe paraqitjen e jashtme. Meshkujt duhet të mbajnë flokët në gjatësi të përshtatshme, ndërsa femrat duhet të kenë nuanca natyrale ngjyrash dhe të shmangin modelet ekstravagante.

- d) Ka shume rëndësi që nëpunësit apo punonjësit që janë me uniformë të tregojnë një paraqitje serioze. Mbajtja e uniformës duhet të përputhet me instruksionet e dhëna për këtë qëllim. Nëpunësit apo punonjësit, duhet të kujdesen që uniformën ta kenë të pastër dhe të rregullt. Çdo riparim ose modifikim i nevojshëm duhet të kryhet për një kohë sa më të shkurtër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

